



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2174/5 prot.

Datë 16.10.2023

**V E N D I M**  
**Nr.1047/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.10.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76170-07-27-2023, me objekt “Blerje kimikate dhe reagente”, me fond limit 6,545,796.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.08.2023, nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Shkodër.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr. 8240, Njësia Nr. 6, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A me adresë: Shkodër Koplík Malësi e Madhe, Linaj-Gruemirë Rezervuari 4000m<sup>3</sup>

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi ë Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 28.07.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76170-07-27-2023, me objekt “Blerje kimikate dhe reagente”, me fond limit 6,545,796.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.08.2023, nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujësjellës Kanalizime Shkodër.

II.2. Në datën 07.08.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 24.08.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Albania Distribution Chemicals ” SHPK	5.004.000 leke	kualifikuar
2. “2 AT” SHPK	5.791.600 leke	kualifikuar
3. “Atlantik 3” SHPK	pa ofertë ekonomike	skualifikuar

II.4. Në datën 29.08.2023 është publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit.

II.5. Me datë 01.09.2023 është publikuar në SPE njoftimi i anulimit të procedurës.

II.6. Në datën 04.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3393 dhe me nr. 2174/2023 prot., datë 06.09.2023 e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor, për anulimin e procedurës së prokurimit objekt – ankimi, konkretisht duke pretenduar se: *“Si fillim duam t’ju tregojmë një situatë të ngjashme, me të njëjtin mall objekt prokurimi “Blerje kimikate që ka ndodhur me autoritetin kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Durrës.*

*AK, Ujësjetllës Kanalizime Durrës, më datë 03.03.2023 mbylli procedurën e prokurimit “Blerje kimikate”, dhe pasi u ndoqën të gjitha procedurat dhe afatet e ankimimit, u shpall fitues një operator ekonomik. Në këtë periudhë Ujësjetllës Kanalizime Durrës iu nënshtrua procesit të transferimit të të drejtave dhe detyrimeve të subjektit me kompetenca të përbashkëta shoqëria rajonale ujësjetllës kanalizime Durrës sh.a me niptin e ri M22031502M. Mbështetur pikërisht në transferimin e të drejtave dhe detyrimeve dhe kompetencave të përbashkëta mes subjektit të vjetër UK Durrës, dhe subjektit të ri, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a, më datë 05.06.2023, me nr. buletini 51 ( gjeni bashkangjitur ) autoriteti i ri kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a, ka njoftuar OE të shpallur fitues nga autoriteti i vjetër kontraktor, për tu paraqitur për nënshkrimin e kontratës me Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a me Niptin e ri M22031502M, kujtojmë përsëri procedure kjo e hedhur nga autoriteti UK Durrës përpara se t’i nënshtrohej procesit të transferimit të të drejtave dhe detyrimeve të subjektit me kompetenca të përbashkëta shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a me Niptin e ri M22031502M.*

*Thënë sa më sipër ndodhemi në të njëjtën situatë në të cilën autoriteti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Shkodër do t’i nënshtrohet procesit të transferimit të të drejtave dhe detyrimeve të subjektit me kompetenca të përbashkëta shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër me Niptin e ri M22031502M.*

*Duke qenë se autoritetit të ri kontraktor po i transferohen të gjitha të drejtat, detyrimet, dhe kompetencat e autoritetit të vjetër, detyrimi i këtij autoritetit të ri është të lidhë dhe të vazhdojë kontratat për procedurat e hedhura nga autoriteti i vjetër. Për këtë arsye AK Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a duhet t’i referohej edhe rastit të Ujësjetllës Kanalizime Durrës si mënyra e vetme legjitime për zgjidhjen e kësaj problematike, rast i cili është pranuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, e cila ka aprovuar lidhjen e kësaj kontrate, në kushtet e vazhdimësisë së të drejtave dhe detyrimeve të mbartura nga autoriteti i vjetër kontraktor, duke krijuar kështu një precedent ligjor të pakontestueshëm dhe të referueshëm për raste të ngjashme. Për sa më sipër kërkohet që ankesa jonë të pranohet dhe kontrata të lidhet me autoritetin e ri kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku*

*Shkodër, të cilit i janë transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e autoritetit të vjetër, Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a”*

II.7. Gjithashtu, me datë 30.08.2023, operatori ekonomik ankimues përmes komunikimit elektronik zyrtar, i është drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik, duke vënë në dijeni edhe KPP me përmbajtjen si vijon: “

*“Ne vijim te kerkeses qe ju kemi derguar ne emailin tone te pare, Autoriteti Kontraktor ka anuluar proceduren e prokurimit me arsyen se ju si APP keni kthyer pergjigje se : te gjitha procedurat qe jane ne progres duhet te finalizohen ne sistem, nuk mund te trasferohen ne llogari te subjektit te ri ( gjeni bashkangjitur shkresen tuaj).*

*Po me te njejtin rast per te njejten procedure Autoriteti Kontraktor “Ujesjelles Kanalizime Durres” zhvilloj proceduren e prokurimi dhe e finalizoi lidhi kontraten me Niptin e ri “Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres sha , M22031502M” (gjeni bashkangjitur buletinin qe ju keni nxjerre).*

*Ndodhur ne keto kushte ju duhet te merni masat mqs ose te detyroni Autoritetin Kontraktor te firmose kontraten me niptin e ri, ose ju duhet te anuloni kontraten e nenshkruar nga Autoriteti “Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres sha”.*

*Jemi ne pergjigje dhe te zgjidhjes nga ana juaj, mqs jeni Institucioni qe Autoriteti Kontraktor “Ujesjelles Kanalizime Shkoder” i eshte referuar anulimit te kesaj procedure. Faleminderit.”*

II.8. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.2174/2 prot., datë 06.09.2023.

II.9. Me shkresën nr. 2174/3 prot., datë 28.09.2023, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A, mbi detyrimin e këtij të fundit për dhënie informacioni KPP, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

II.10. Nëpërmjet shkresës me nr. 671/1 prot., datë 03.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2174/4 prot., datë 09.10.2023 me objekt “*Informacion në lidhje me shkresën nr. 2174/3 prot., datë 28.09.2023*” është depozituar nga Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A, në Komisionin e Prokurimit Publik, akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se nuk e ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK” duke argumentuar:

*“Në përgjigje të shkreses tuaj nr. 2174/3 prot, datë 28.09.2023 të protokolluar nga jone me nr. 671 prot, datë 02.10.2023, në lidhje me ankesen e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals”, për proceduren e prokurimit me objekt “Blerje kimikate dhe reagente” me nr. reference 76170-07-27-2023 të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Shkodër , ju informojme si më poshte:*

*Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt J66902052A është në proces likuidimi, pasi që nga data 01.09.2023 ka transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet tek subjekti me kompetenca të përbashkëta Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt-M378197010).*

*Ky transferim bazohet në VKM nr. 302, datë 11.05.2022” Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin, trajtimin dhe përpunimin e ujerave të ndotura”, në vendimin e Këshillit Bashkiak Shkodër nr.38, datë 26.07.2022 “Për pjesëmarrjen e Bashkisë Shkodër në subjektin me kompetenca të përbashkëta, me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimin të ujerave të ndotura, në vendimin nr.3, date 10.07.2023 të Asamblesë të Aksionareve “Për zmadhimin e kapitalit dhe pranimin të aksionarit të ri Ujësjiellës Kanalizime Shkodër”, ne Kontratën noteriale për transferim aktivitetit nr. repertori 2722, datë 13.07.2023*

*Më qëllim për të sqaruar ecurinë e mëtejshme të procedurave të prokurimit që ishin në proces, Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt- J66902052A ne pozicionin e autoritetit kontraktor me datë 28.08.2023 kërkoi me email nga Agjencia e Prokurimeve Publike rekomandim në lidhje me procedurat e prokurimit të cilat ishin në fazën e ndërmjetme (pritje ofertash, vlerësim, njoftim fituesi etj.), por gjithmonë para lidhjes së kontratës, si dhe mundësinë e transferimit të tyre tek subjekti i ri (Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt-M378197010).*

*Me emailin e datës 29.08.2023 drejtuar Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a, Agjencia e Prokurimeve Publike, njofton se të gjitha procedurat që janë në progres duhet të finalizohen në sistem, nuk mund të transferon në llogari të subjektit të ri.*

*Për sa më sipër, referuar dosjes së prokurimit, Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt J66902052A me shkresën nr.1583 prot, datë 30.08.2023 ka anuluar procedurën e prokurimit bazuar në nenin 98 pika 1,ç të ligjit nr. 162/2020.*

*Ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals”, nuk është shqyrtuar për dy arsye:*

*Së pari: Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt-J66902052A ka mbyllur aktivitetin, pasi ky subjekt nga data 01.09.2023 ka transferuar të drejtat dhe detyrimet tek Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt M378197010, për rrjedhojë nuk ka asnjë të punësuar, përveç likuidatorit të shoqërisë dhe anëtareve të këshillit të administrimit.*

*Së dyti: Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt M378197010, nuk e ka shqyrtuar ankesën, për arsye se ankesa e bërë nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” nuk i është drejtuar Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt M378197010, por Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt-*

*J66902052A. Në këto kushte e kemi patur te pamundur nga ana procedurale për të marre në shqyrtim ankesën.*

*Bashkëngjitur po ju dërgojmë,*

*Proces-verbalin e vlerësimit të mbajtur nga KVO-ja*

*Formularin e njoftimit të fituesit dhe botim ne APP*

*Formularin e anulimit të procedurës dhe botimin e anulimit ne APP*

*Kërkese drejtuar APP me email datë 28.08.2023*

*Kthim përgjigje me email nga APP datë 29.08.2023”*

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar, nuk kanë dorëzuar pranë KPP formularin e argumenteve në përputhje me nenin 113 të LPP-së nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave dhe as në formë shkresore.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, mbi anulimin e procedurës së prokurimit nga autoriteti kontraktor me arsyen se: *“Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt J66902052A është në proces likuidimi, pasi që nga data 01.09.2023 ka transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet tek subjekti me kompetenca të përbashkëta Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt-M37819701O.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 07.08.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Në datën 24.08.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Albania Distribution Chemicals ” SHPK	5.004.000 leke	kualifikuar
2. “2 AT” SHPK	5.791.600 leke	kualifikuar
3. “Atlantik 3” SHPK	pa ofertë ekonomike	skualifikuar

III.1.3. Në datën 29.08.2023, është publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit.

III.1.4. Me datë 01.09.2023 është publikuar në SPE njoftimi i anulimit të procedurës.

III.1.5. Në datën 04.09.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3393 dhe me nr. 2174/2023 prot., datë 06.09.2023, e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi konkretisht duke pretenduar se: *“Si fillim duam t’ju tregojmë një situatë të ngjashme, me të njëjtin mall objekt prokurimi “Blejre kimikate që ka ndodhur me autoritetin kontraktor Ujësjellës Kanalizime Durrës. AK, Ujësjellës Kanalizime Durrës, më datë 03.03.2023 mbylli procedurën e prokurimit “Blerje kimikate”, dhe pasi u ndoqën të gjitha procedurat dhe afatet e ankimimit, u shpall fitues një operator ekonomik. në këtë periudhë ujësjellës kanalizime Durrës iu nënshtrua procesit të transferimit të të drejtave dhe detyrimeve të subjektit me kompetenca të përbashkëta shoqëria rajonale ujësjellës kanalizime Durrës sh.a me niptin e ri M22031502M.*

*Mbështetur pikërisht në transferimin e të drejtave dhe detyrimeve dhe kompetencave të përbashkëta mes subjektit të vjetër UK Durrës, dhe subjektit të ri, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a, më datë 05.06.2023, me nr. buletini 51 (gjeni bashkangjitur) autoriteti i ri kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a, ka njoftuar OE të shpallur fitues nga autoriteti i vjetër kontraktor, për t’u paraqitur për nënshkrimin e kontratës me Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a me Niptin e ri M22031502M, kujtojmë përsëri procedure kjo e hedhur nga autoriteti UK Durrës përpara se t’i nënshtrohet procesit të transferimit të të drejtave dhe detyrimeve të subjektit me kompetenca të përbashkëta shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a me Niptin e ri M22031502M.*

*Thënë sa më sipër ndodhemi në të njëjtën situatë në të cilën autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Shkodër do t’i nënshtrohet procesit të transferimit të të drejtave dhe detyrimeve të subjektit me kompetenca të përbashkëta Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër me Niptin e ri M22031502M.*

*Duke qenë se autoritetit të ri kontraktor po i transferohen të gjitha të drejtat, detyrimet, dhe kompetencat e autoritetit të vjetër, detyrimi i këtij autoritetit të ri është të lidhë dhe të vazhdojë kontratat për procedurat e hedhura nga autoriteti i vjetër. Për këtë arsye AK Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a duhet ti referohet edhe rastit të Ujësjellës Kanalizime Durrës si mënyra e vetme legjitime për zgjidhjen e kësaj problematike, rast i cili është pranuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, e cila ka aprovuar lidhjen e kësaj kontratës, në kushtet e vazhdimësisë së të drejtave dhe detyrimeve të mbartura nga autoriteti i vjetër kontraktor, duke krijuar kështu një precedent ligjor të pakontestueshëm dhe të referueshëm për raste të ngjashme. Për sa më sipër kërkojmë që ankesa jonë të pranohet dhe kontrata të lidhet me autoritetin e ri kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër, të cilit i janë transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e autoritetit të vjetër, Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a”.*

III.1.6. Gjithashtu, me datë 30.08.2023 operatori ekonomik ankimues përmes komunikimit elektronik zyrtar i është drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik, duke vënë në dijeni edhe KPP me përmbajtjen si vijon: *“Ne vijim të kërkeses që ju kemi derguar ne emailin tone te*

*pare, Autoriteti Kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit me arsyen se ju si APP keni kthyer përgjigje se : te gjitha procedurat qe jane ne progres duhet te finalizohen ne sistem, nuk mund te transferohen ne llogari te subjektit te ri ( gjeni bashkangjitur shkresen tuaj).*

*Po me te njejtin rast per te njejten procedure Autoriteti Kontraktor “Ujesjelles Kanalizime Durres” zhvilloi proceduren e prokurimit dhe e finalizoi lidhi kontraten me Niptin e ri “Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres sha , M22031502M” (gjeni bashkangjitur buletin qe ju keni nxjere).*

*Ndodhur ne keto kushte ju duhet te merni masat mqs ose te detyroni Autoritetin Kontraktor te firmose kontraten me niptin e ri, ose ju duhet te anuloni kontraten e nenshkruar nga Autoriteti “Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres sha”.*

*Jemi ne përgjigje dhe te zgjidhjes nga ana juaj, mqs jeni Institucioni qe Autoriteti Kontraktor “Ujesjelles Kanalizime Shkoder” i eshte referuar anulimit te kesaj procedure.*

*Faleminderit.”*

III.1.7. Me shkresën nr. 2174/3 prot., datë 28.09.2023 KPP iu drejtua Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A mbi detyrimin e kësaj të fundit për dhënie informacioni KPP, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

III.1.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 671/1 prot., datë 03.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 62174/4 prot., datë 09.10.2023 me objekt “Informacion në lidhje me shkresën nr. 2174/3 prot., datë 28.09.2023”, është depozituar nga Shoqëria Rajonale e Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A në Komisionin e Prokurimit Publik, akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes, ku konstatohet, se ajo nuk e ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK” duke argumentuar:

*“Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 2174/3 prot, datë 28.09.2023 të protokolluar nga jone me nr. 671 prot, datë 02.10.2023, në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals”, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kimikate dhe reagente” me nr. reference 76170-07-27-2023 të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Shkodër , ju informojme si më poshte:*

*Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt J66902052A është në proces likuidimi, pasi që nga data 01.09.2023 ka transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet tek subjekti me kompetenca të përbashkëta Shoqeria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt-M378197010).*

*Ky transferim bazohet në VKM nr. 302, datë 11.05.2022” Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin, trajtimin dhe përpunimin e ujerave të ndotura”, në vendimin e Këshillit Bashkiak Shkodër nr.38, datë 26.07.2022 “Për pjesëmarrjen e Bashkisë Shkodër në subjektin me kompetenca të përbashkëta, me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të*



ujerave të ndotura, në vendimin nr.3, date 10.07.2023 të Asamblesë të Aksionareve “Për zmadhimin e kapitalit dhe pranimin të aksionarit të ri Ujësjetllës Kanalizime Shkodër”, ne Kontratën noteriale për transferim aktivitetit nr. repertori 2722, datë 13.07.2023.

Më qëllim për të sqaruar ecurinë e mëtejshme të procedurave të prokurimit që ishin në proces, Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt- J66902052A ne pozicionin e autoritetit kontraktor me datë 28.08.2023 kërkoi me email nga Agjencia e Prokurimeve Publike rekomandim në lidhje me procedurat e prokurimit të cilat ishin ne fazen e ndërmjetme (pritje ofertash, vlerësim, njoftim fituesi etj.), por gjithmonë para lidhjes së kontratës, si dhe mundësinë e transferimit të tyre tek subjekti i ri (Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt-M378197010).

Me email e datës 29.08.2023 drejtuar Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a , Agjencia e Prokurimeve Publike, njofton se të gjitha procedurat që janë në progres duhet të finalizohen në sistem, nuk mund të transferon në llogari të subjektit të ri.

Për sa më sipër, referuar dosjes së prokurimit, Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt J66902052A me shkresën nr.1583 prot, datë 30.08.2023 ka anuluar procedurën e prokurimit bazuar në nenin 98 pika 1,ç të ligjit nr. 162/2020.

Ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” nuk është shqyrtuar për dy arsye:

Së pari: Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt-J66902052A ka mbyllur aktivitetin, pasi ky subjekt nga data 01.09.2023 ka transferuar të drejtat dhe detyrimin tek Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt M378197010, për rrjedhojë nuk ka asnjë të punësuar, përveç likuidatorit të shoqërisë dhe anëtareve të këshillit të administrimit.

Së dyti: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt M378197010, nuk e ka shqyrtuar ankesën , për arsye se ankesa e bërë nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” nuk i është drejtuar Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Qarku Shkodër me nr. nipt M378197010, por Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a me nr.nipt-J66902052A. Në keto kushte e kemi patur te pamundur nga ana procedurale për të marrë në shqyrtim ankesën. Bashkëngjitur po ju dërgojmë,

Proces-verbalin e vlerësimit të mbajtur nga KVO-ja  
Formularin e njoftimit të fituesit dhe botim në APP  
Formularin e anulimit të procedurës dhe botimin e anulimit në APP  
Kërkese drejtuar APP me email datë 28.08.2023  
Kthim përgjigje me email nga APP datë 29.08.2023.”

III.1.9. Në nenin 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimi publik” parashikohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;
  - b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;
  - d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.
2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna.
3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.
4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit.
5. Autoriteti ose enti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të ankimimit sipas parashikimeve të nenit 110 të këtij ligji.”

III.1.10. Në nenin 26 pika 6, paragrafi i parë të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

III.1.11. Në nenin 32 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike.”

III.1.12. Në pikën 1-5, të kreut II “Riorganizimi i sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” parashikohet se;

“1. Për kryerjen e funksioneve në dobi të përbashkët dhe përmirësimin e cilësisë të shërbimeve të ofruara në sektorin e furnizimit me ujë, si dhe largimit, trajtimit e përpunimit të ujërave të ndotura, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore që bien dakord për riorganizimin e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, që ushtrojnë veprimtarinë brenda kufijve të juridiksionit territorial të tyre, nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, sipas formatit tip të përcaktuar në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të marrëveshjes së bashkëpunimit, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, riorganizohen si subjekte me kompetenca të përbashkëta (në vijim, SKP), të cilat janë shoqëri të reja aksionare të krijuara sipas sistemit të administrimit me dy nivele, në përputhje me formatin e statutin tip, të përcaktuar në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Në momentin e krijimit, SKP-së i transferohen të gjitha të drejtat, detyrimet, si dhe veprimtaria ekonomike e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore.

4. Riorganizimi i SKP-ve, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij kreu, fillon në vitin 2022 dhe përfundon sipas një programi të bashkërenduar ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

5. Marrëveshja hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga palët dhe është marrë shprehja e ligjshmërisë së marrëveshjes nga ana e prefektit të qarkut/prefektëve të qarqeve, sipas kërkesave të nenit 14, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.”

III.1.13. Nisur nga arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe veprimet e autoritetit kontraktor Ujësjellës Kanalizime Shkodër SH.A, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi sepse në rastin konkret nuk jemi para asnjërës prej arsyeve që referon neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimi publik” për anulimin e procedurës së prokurimit. Arsyeja që ka përdorur autoriteti kontraktor për anulimin e procedurës konkretisht pika ç) e nenit 98 të LPP-së “Për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;” nuk qëndron, pasi nuk jemi para rrethanave të paparashikueshme, sepse autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Shkodër SH.A, e ka kaluar veprimtarinë e tij te një autoritet tjetër kontraktor, si Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A, në bazë të një akti nënligjor siç është VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i cili në vetvete ka përcaktuar procedura dhe afate kohore që duhen ndjekur për secilën prej procedurave deri në finalizimin e krijimit të shoqërive me përgjegjësi të përbashkët (SKP) në kuptim të aktit nënligjor të mësipërm. Në këtë kuadër jemi përballë një procesi që ka filluar në muajin maji të vitit 2022 dhe autoritetet kontraktore që do të riorganizoheshin sipas këtij akti kanë patur në dispozicion procedura dhe afate kohore të qarta dhe nuk mund të jemi kurrsesi përballë rrethanave të paparashikueshme siç autoriteti kontraktor ka shprehur në arsyen e anulimit të procedurës. Nga ana tjetër bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik konkretisht nenin 26 pika 6, paragrafi i parë të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik” i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.” kemi një akt administrativ të KVO-së së autoritetit kontraktor (vendimin e KVO-së), i cili pas veprimeve sipas nenit 26 të aktit nënligjor më sipër, ka konkluduar me një fitues paraprak sipas njoftimit të fituesit të publikuar në SPE me datë 29.08.2023, i cili rezulton të jetë operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK. Po ashtu sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” shoqëritë rajonale ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve (në rastin konkret autoritetit kontraktor Ujësjellës kanalizime Shkodër SHA) pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të marrëveshjes së bashkëpunimit, riorganizohen si subjekte me kompetenca të përbashkëta (në vijim SKP) të cilat janë shoqëri të reja aksionare të krijuara sipas sistemit të administrimit me dy nivele (në këtë rast Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A). Akoma më tej, në pikën 3, paragrafi i fundit i kreut II të aktit nënligjor më sipër përcaktohet se: “Në momentin e krijimit, SKP-së i transferohen të gjitha të drejtat, detyrimet, si dhe veprimtaria ekonomike e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore.” Duke analizuar situatën më sipër, ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe aktin nënligjor përkatës mbi riorganizimin e shoqërive ujësjellës kanalizime ekzistuese si shoqëri me kompetenca të përbashkëta, KPP gjykon, se të gjithë të drejtat edhe detyrimet që i kanë lindur shoqërisë ekzistuese të Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sh.A nga vendimi i KVO-së së autoritetit kontraktor mbi vlerësimin e procedurës së prokurimit dhe publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, i transferohen SKP-së, pra në rastin konkret Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër Sh.A, e cila duhet të vazhdojë konform parashikimeve të mëtejshme të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, me hapat e mëtejshëm për finalizimin e kësaj procedure prokurimi. Komisioni shkon akoma më tej me arsyetimin e tij dhe gjykon, se Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vijimin e hapave të mëtejshëm për anulimin e procedurës së prokurimit i materializuar përmes aktit “Formular i Njoftimit të Anulimit” me nr. 1583 prot., datë 30.08.2023, i autoritetit kontraktor Ujësjellës-Kanalizime Shkodër SHA, ka natyrën e aktit administrativ, në kuptim të nenit 3, pika 1 të K.Pr.A, (ligji 44/2015) “çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektesh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se akti administrativ “Formular i Njoftimit të Anulimit” me nr. 1583 prot., datë 30.08.2023, do të konsiderohet si akt absolutisht i pavlefshëm, pasi vijimi i autoritetit kontraktor me anulimin e procedurës së prokurimit i pabazuar ligjërisht, e bën atë absolutisht të pavlefshëm si veprim procedural. Në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjisllacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;

b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.” Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet, se “Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest). Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA, në të cilën parashikohet, se “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.”, në këtë kuadër duhet të merren masat për anulimin e anulimit të procedurës së prokurimit. Komisioni thekson faktin, se në rastin konkret Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër Sh.A me veprimin për anulimin e procedurës ka cenuar edhe parimin e sigurisë juridike për të cilin në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur, se “Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”. Në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese Inter Allia në vendimin 15/2010 ka theksuar, se “parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore”. KPP gjykon, se çdo autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efijencës parashikuar në nenin 2 të LPP-së. Në këto kushte, ashtu siç ka theksuar më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se të gjithë të drejtat edhe detyrimet që i kanë lindur shoqërisë ekzistuese të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër Sh.A nga vendimi i KVO-së së autoritetit kontraktor mbi vlerësimin e procedurës dhe publikimin e njoftimit të fituesit paraprak, i transferohen SKP-së, pra në rastin konkret Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër, e cila duhet të vazhdojë konform parashikimeve të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik me hapat e mëtejshëm për finalizimin e kësaj procedure prokurimi dhe lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76170-07-27-2023, me objekt “Blerje kimikate dhe reagente”, me fond limit 6,545,796.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.08.2023, nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Shkodër.
  2. Të anulojë vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit.
  3. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A, si shoqëri me kompetenca të përbashkëta, të vazhdojë konform parashikimeve të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik me hapat e mëtejshëm për finalizimin e kësaj procedure prokurimi dhe lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
  4. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër SH.A, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
  5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
  6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

